

Ky libër prezanton një përmbledhje të shkëlqyer të debatit mbi origjinën. Si një inxhinier me përvojë, Dominik Statham është mjaft i kualifikuar për të ndërmarrë detyrën e analizimit të një numri të madh dëshmish të debatueshme dhe për të nxjerrë përfundime të drejta dhe të arsyetuara.

Titulli është shumë i përshtatshëm, për shkak se shpesh ka më shumë besim se sa shkencë kur vjen puna për besimin e teorisë së evolucionit. Shumë evolucionistë besojnë në lindjen e vetvetishme të jetës, pavarësisht nga fakti se askush nuk ka mundur ta riprodhojë dot atë në laborator në gjashtëdhjetë vitet e fundit. Shumë evolucionistë besojnë se mutacionet e gjeneve mund të sjellin informacion të ri dhe struktura të reja, pavarësisht nga fakti se askush nuk mund të japë shembuj të qartë se këto gjëra janë duke ndodhur në botën natyrore.

Dominik Statham ka gjetur shumë citime të thëna nga evolucionistët. Nëse evolucioni është një fakt i shkencës, përse atëherë kaq shumë evolucionistë shprehin dyshime për evolucionin në vetë fushën e tyre? Citimet tregojnë se mediat e kanë gabim kur thonë se komuniteti shkencor e pranon evolucionin si një fakt të padiskutueshëm të shkencës.

Libri gjithashtu adreson një pyetje thelbësore lidhur me a është evolucion i pajtueshëm me Biblën apo jo? Mund të ketë një tundim të fortë për ta pranuar teorinë e evolucionit me qëllim që të dukesh sikur je mik i shkencës. Por pranimi i evolucionit përfshin pranimin e një ideologjie, e cila në themel është kundër Perëndisë dhe Biblës. Edhe sikur të ishte i mundur evolucioni, ai nuk është në pajtim me atë që zbulon Bibla për krijimin apo për karakterin e Perëndisë. Shkrimet zbulojnë se Perëndisë iu desh vetëm të thotë fjalën që ta krijonte botën.

Jam i sigurt se ky libër i shkëlqyeshëm do të jetë një ndihmë e madhe për shumë njerëz që duan të dinë të vërtetën për origjinën.

Stjuart Burgess

Profesor i Natyrës dhe Projektimi, Universiteti i Bristolit